



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI I ELBASANIT "ALEKSANDËR XHUVANI"  
SENATI AKADEMIK

Nr. 651 / prot.  
19

Elbasan, më 10.03.2025

VENDIM

Nr. 21 datë 10.03.2025

"Për

miratimin e zhvillimin e programit të ciklit të dytë të studimit Master i shkencave në "Psikologji edukimi" edhe në gjuhën angleze, në Fakultetin e Shkencave të Edukimit në Universitetin e Elbasanit "Aleksandër Xhuvani", për vitin akademik 2025-2026"

Bazuar në Ligjin nr. 80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", neni 3, pika 2; neni 35, pika 1; neni 38 pika 1, gërma "dh"; neni 88, në Udhëzimin nr. 1, datë 14.01.2020 "Për dokumentacionin dhe procedurat për hapjen riorganizimin dhe mbylljen e IAL, degëve të tyre, njësisve kryesore dhe programeve të studimit, si dhe për ndarjen ose bashkimin e IAL", Kreu IV, gërma "A", i ndryshuar, në Statutin e Universitetit të Elbasanit "Aleksandër Xhuvani" neni 9, gërma "gj" dhe neni 22, pika 1/a, me propozim të Departamentit të Psikologjisë, Senati Akademik,

VENDOSI:

1. Të miratojë zhvillimin e programit të ciklit të dytë të studimit "Master i shkencave" në "Psikologji edukimi"/"Educational psychology" edhe në gjuhën angleze, pranë Fakultetit të Shkencave të Edukimit, në Universitetin e Elbasanit "Aleksandër Xhuvani", për vitin akademik 2025-2026, sipas dokumentacionit bashkëngjitur.
2. Të miratojë formën e diplomës për programin e ciklit të dytë të studimit "*Master of science in Educational psychology*", sipas modelit bashkëngjitur.
3. Dokumentacioni përkatës të ngarkohet në platformën e-Albania për miratim të metejshëm nga Ministria e Arsimit dhe Sportit.
4. Dokumentacioni përkatës të përcillet në QSHA për regjistrimin e formës së diplomës.
5. Vendimi i Senatit Akademik t'i përcillet Bordit të Administrimit për veprime të metejshme.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI  
Prof. Dr. Elvira Fetahu  


